



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.41

25 prill

2012

P Ë R M B A J T J A

Vendim i KM
nr. 204, datë 21.3.2012

Për miratimin e “Dokumentit bazë, si pjesë përbërëse e raporteve të shteteve palë në konventat e OKB-së për të drejtat e njeriut”.....

Faqe

2231

VENDIM
Nr. 204, datë 21.3.2012

PËR MIRATIMIN E “DOKUMENTIT BAZË, SI PJESË PËRBËRËSE E RAPORTEVE TË SHTETEVE PALË NË KONVENTAT E OKB-SË PËR TË DREJTAT E NJERIUT”

Në mbështetje të neneve 100 dhe 122 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e “Dokumentit bazë, si pjesë përbërëse e raporteve të shteteve palë në konventat e OKB-së për të drejtat e njeriut”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DOKUMENTI BAZË
SI PJESË PËRBËRËSE E RAPORTEVE TË SHTETEVE PALË NË KONVENTAT E OKB-SË PËR TË DREJTAT E NJERIUT
Shqipëria (2002-2011)

Lista e shkurtimeve

DAP	Departamenti i Administratës Publike
INSTAT	Instituti i Statistikave të Republikës së Shqipërisë
KQZ	Komisioni Qendror Zgjedhor
Kuvendi	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
MF	Ministria e Financave
MPÇSSHB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
MPPT	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
RTSH	Radio Televizioni Shqiptar

HYRJE

1. Dokumenti bazë si pjesë përbërëse e raporteve në kuadër të konventave të OKB-së për të drejtat e njeriut (i rishikuar) i paraqitur nga Qeveria Shqiptare, është hartuar mbështetur në udhëzimet e harmonizuara (Harmonized Guideline¹), lidhur me raportimin në kuadër të traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

2. Bazuar në këto udhëzime, dokumenti bazë (Core Document), si dhe dokumentet lidhur me instrumentet ndërkombëtare specifike për të drejtat e njeriut, dokumenti bazë i paraqitur nga vendi ynë përbën një pjesë integrale të raporteve të paraqitura në kuadër të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

3. Dokumenti bazë si pjesë përbërëse e raporteve të shteteve palë në konventat e OKB-së për të drejtat e njeriut, i paraqitur nga Shqipëria përmban informacione të përgjithshme lidhur me zbatimin e

¹ Dokumenti HRI/MC/2006, i paraqitur më 10 maj 2006: HRI/GEN/2 Rev.6



traktateve specifike në kuadër të të drejtave të njeriut në të cilat Shqipëria është palë, informacione të cilat do të jenë të nevojshme (relevante) për mekanizmat e traktateve specifike për të drejtat e njeriut.

4. Dokumenti i parë bazë² është paraqitur nga Shqipëria në vitin 2003³ dhe bazuar në udhëzimet e harmonizuara të rishikuara (HRI/GEN/2 Rev.6), Shqipëria paraqet një version të ri të rishikuar të dokumentit bazë. Ky dokument bazë i rishikuar përfshin informacione të përgjithshme mbështetur në udhëzimet e sipërcituara lidhur me gjendjen ekonomike, sociale, kulturore, strukturën kushtetuese politike, ligjore, kuadrin e përgjithshëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, kuadrin ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar etj. për periudhën kohore, përkatësisht vitet 2002-2011.

5. Në kuadrin e përgatitjes së këtij dokumenti, Ministria e Punëve të Jashtme, si institucioni përgjegjës për hartimin e raporteve kombëtare në kuadër të të drejtave të njeriut ka informuar autoritetet publike kompetente dhe është ngritur një grup pune ndërinstitucional në lidhje me hartimin e këtij dokumenti. Ky raport është përgatitur nga Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Institutin e Statistikave, si dhe institucionet e tjera qendrore dhe institucione të pavarura, të listuara më poshtë.

I. Informacion i përgjithshëm mbi Shqipërinë

A. Karakteristikat demografike, sociale dhe kulturore të vendit

A. i Karakteristikat kombëtare të vendit

6. Republika e Shqipërisë është një shtet evropian, i cili shtrihet në pjesën juglindore të Gadishullit Ballkanik. Kufiri tokësor i shtetit shqiptar kufizohet nga Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, Greqia, ndërsa riviera e tij laget nga detet Adriatik dhe Jon. Gjatësia e vijës kufitare është 1094 km, ndër këto 657 km përbëjnë kufirin tokësor, 316 km janë kufi bregdetar, 48 km janë kufi lumor dhe 73 km kufi liqenor.

7. Sipërfaqja e territorit të Republikës së Shqipërisë është 28,748 km². Relievi shqiptar është kryesisht malor. Lartësia mesatare e tij është 708 metra. Maja më e lartë në vend është Maja e Korabit me 2751 m mbi nivelin e detit. Fushat zënë kryesisht pjesën perëndimore, përgjatë bregdetit Adriatik, por ka edhe në pjesë të tjera të vendit. Territori i Shqipërisë ndahet në katër krahina të mëdha natyrore: a) alpet shqiptare; b) krahina malore qendrore; c) krahina malore jugore dhe d) ultësira bregdetare.

8. Kryeqyteti i vendit është Tirana. Ai u shpall si i tillë në vitin 1920. Festa Kombëtare e Republikës së Shqipërisë është data 28 nëntor (Dita e Flamurit). Gjuha zyrtare është gjuha shqipe, një gjuhë indoeuropiane që përfaqëson një degë të veçantë në familjen e gjuhëve indoeuropiane. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare. Përbërja fetare e popullsisë përfshin besimtarë ortodoksë, katolikë, myslimanë dhe bektashinj. Minoritetet kombëtare dhe gjuhësore të njohura në vend janë ato greke, maqedonase, serbe, malazeze, vllahe/arumune dhe rome.

A. ii Karakteristikat demografike dhe etnike

9. Më 1 tetor 2011, Shqipëria kreu Censusin e Popullsisë dhe banesave 2011. Nga vlerësimet paraprake, popullsia e Republikës së Shqipërisë rezultoi 2,831,741 banorë, ndërkohë që numri i popullsisë nga Censusi i kaluar, i vitit 2001 ishte 3,069,275 banorë. Sipas këtyre vlerësimeve, ky tregues ka pësuar një zbritje me rreth 7.7% gjatë këtyre dhjetë vjetëve. Supozohet që shkaqet kryesore të këtij zvogëlimi janë të shumta, të cilat do të studiohen pas përfundimit të rezultateve finale të Censurit 2011. Megjithatë, si shkaqe kryesore të kësaj rënieje të popullsisë mund të përmenden: rënia e lindshmërisë, emigracioni etj. Për rrjedhojë edhe dendësia e popullsisë ka rënë nga 106 banorë në 98.5 banorë për km² (tabela 1, aneksi nr. 3).

² Dokumenti i parë bazë i paraqitur nga Shqipëria përmban informacione për periudhën 1991-2001

³ HRI/CORE/1/Add.124 18.7.2003 *Core document forming part of the reports of States Parties*
<http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G03/431/45/PDF/G0343145.pdf?OpenElement>

10. Momentalisht nuk mund të flitet për një numër të saktë të anëtarëve të minoriteteve që jetojnë brenda territorit shqiptar, ashtu sikurse nuk mund të deklarohen të dhëna të sakta për përkatësinë fetare dhe gjuhën amtare të popullsisë. Të dhënat e sakta do të publikohen pas shpalljes së rezultateve zyrtare të Censusit 2011.

11. Për herë të parë në historinë e censuseve të zhvilluara në Shqipëri, ky i fundit konstatoi se pjesa më e madhe e popullsisë së Shqipërisë (rreth e 53.7%) është e vendosur në zonat urbane dhe 46,3% në atë rurale (tab.1/aneksi 3).

12. Lëvizjet migratore jashtë vendit tregojnë se “Shqiptarët” përbëjnë një nga grupet migratore më të mëdha në vendet e BE-së (rreth 0.8 milionë shtetas). Vlerësohet se 20% e popullsisë shqiptare është larguar nga vendi dhe jeton jashtë tij⁴. Statistikat e MPCSSH-së tregojnë se shpërndarja e shtetasve shqiptarë në botë është e orientuar kryesisht drejt vendeve të Europës Perëndimore, e më pak drejt kontinentit amerikan.

12.1 Personat ekonomikisht aktivë (moshat 15-64 vjeç) përbëjnë sa 65% e anëtarëve të familjeve. Kjo shifër është disi më e lartë në zonat urbane (67%) krahasuar me ato rurale (63%). Pjesa tjetër e popullsisë (personat nën 15 vjeç dhe ata në moshën 65 vjeç e sipër) përbën popullsinë ekonomikisht të varur. Fëmijët nën 15 vjeç përbëjnë 23% të popullsisë, ndërsa personat e moshuar të moshës 65 vjeç e sipër përbëjnë vetëm 12% të saj.

13. Numri i popullsisë mesatare për grupmoshat 0-14 vjeç dhe 15-65 vjeç ka qenë më i lartë për gjininë “mashkullore” (përkatësisht 52% dhe 51%). Për kategorinë e grupmoshës 65 vjeç e sipër, raporti ka ndryshuar në favor të femrave, duke arritur në nivelin e 61%⁵ (tab.2/aneksi 3).

14. Statistikat e lindjeve dhe të vdekjeve deklarojnë gjithashtu ndryshime të këtyre treguesve për vitet 2002–2008. Gjatë kësaj periudhe kohore ka pasur një ulje të treguesit të lindjeve gjallë, me gati 20%. Në lindjet e regjistruara për vitin 2008, rreth 52% e fëmijëve të lindur gjallë kanë qenë të gjinisë “mashkullore” (tab.3/aneksi 3).

15. Krahasimi i rezultateve të studimit të shëndetit riprodhues në Shqipëri dhe studimit ADHS, tregojnë për një rënie të nivelit të fertilitetit (TFR) në vend (tabela 4/aneksi 3). Në vitet 1999-2002 ky tregues ishte 2.6 fëmijë për çdo grua, ndërsa në periudhën 2006-2008 ky tregues pësoi një rënie duke mbërritur në shifrën 1.6 fëmijë për çdo grua. Aktualisht, niveli i TFR-së është më i lartë në zonat rurale se sa në ato urbane (1.8 kundrejt 1.3 lindje/grua). Edhe pse piku i pjellorisë ndodh në moshën 25-29 vjeç, grupmosha që vendos këtë ndryshim urban-rural të nivelit TFR është ajo midis 20-24 vjeç (64 me 120 lindje/grua)⁶. Madhësia mesatare e familjeve në Shqipëri është 3.8 persona. Familjet me një prind, të kryesuara nga gratë, përbëjnë 16% të familjeve shqiptare. Vetëm 3% e tyre përbëhen nga fëmijë jetimë ose fëmijë nën kujdestari që jetojnë me to.

A. iii Indikatorët socialë, ekonomikë dhe kulturorë

A. iii/1 Indikatorët socialë

16. Skema e ndihmës sociale në Republikën e Shqipërisë përfshin: sigurimin shoqëror, sigurimin shëndetësor, pagesën e papunësisë, ndihmën ekonomike, pagesën për shkak të aftësisë së kufizuar dhe shërbimet shoqërore. Sipas ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (të ndryshuar) ndihma ekonomike që përfitojnë familjet në nevojë është e plotë ose e pjesshme. Ndihmë ekonomike sipas ligjit përfitojnë edhe individët të cilët janë jetimë, viktimat të trafikimit dhe gratë e dhunuara. Pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar përfitojnë paraplegjikët, tetraplegjikët, të verbrit, personat me aftësi të kufizuar mendore, fizike e shqisore dhe invalidët e punës.

17. Kuadri ligjor mbron të punësuarit në rastet e pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit, pensionit familjar, të sëmundjeve, të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, papunësisë dhe barrëllindjet. Përveç skemës së detyrueshme ka filluar të zbatohet edhe kolona e tretë e pensioneve vullnetare për individë që duan një përfitim më të madh në të ardhmen, sipas ligjit nr. 10 197, datë 10.2.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

⁴ Strategjia Kombëtare për Migracionin, 2004

⁵ Statistikat i referohen periudhës së viteve 2005-2009

⁶ Të dhënat e marra nga ADHS 2008-2009



18. Arsimi në Republikën e Shqipërisë është publik dhe privat. Ai publik ka karakter laik. Sistemi arsimor i Republikës së Shqipërisë përbëhet nga këto nivele: edukimi parashkollor përfshin çerdhet që janë në varësi të pushtetit vendor dhe kopshtet të cilat janë në varësi të MASH-it. Procesi mësimor edukativ në arsimin parashkollor zhvillohet mbi bazën e programeve edukative të miratuara nga MASH. Arsimi parashkollor nuk është i detyruar.

19. Arsimi bazë përbën nivelin e detyrueshëm arsimor, që ndiqet prej moshës 6 deri në 16 vjeç. Ai përfshin ciklin fillor dhe ciklin e mesëm të ulët. Prej vitit 2006 kohëzgjatja e ndjekjes së këtij niveli arsimor është 9 vjet (nga 8 vjet që ka qenë më parë). Nxënësit me aftësi të kufizuara e ndjekin këtë nivel arsimi në shkolla ose klasa speciale.

20. Arsimi i mesëm i përgjithshëm përbëhet nga gjimnazet (me kohë të plotë dhe të shkurtuar). Studimet në këtë nivel zgjasin 3 vjet dhe finalizohen me provimet e Maturës Shtetërore.

21. Arsimi profesional, sikurse dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm, vijon pas arsimit bazë 9-vjeçar. Ky nivel synon të përgatisë specialistë të aftë për punë, por edhe nxënës që mund të vazhdojnë arsimin e lartë. Struktura e këtij niveli arsimor është në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar Standard të Arsimit (ISCED), Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) dhe Kornizën Europiane të Kualifikimeve (KEK). Kohëzgjatja e studimeve në këtë nivel shkon 2-4 vjet.

22. Arsimi social-kulturor përfshin shkollat e mesme të gjuhëve të huaja, arteve dhe sporteve. Në varësi të drejtimit të arsimit, kohëzgjatja e studimeve në këtë nivel është 3 ose 4 vjet.

23. Arsimi i lartë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje dhe me Strategjinë kombëtare për arsimin e lartë 2008-2013 (SKALA) dhe me Strategjinë kombëtare të shkencës, teknologjisë dhe inovacionit 2009-2015, zbaton prej vitit 2003 kriteret e Deklaratës së Bolonjës. Në përputhje me parimet e hapësirës europiane, institucionet e arsimit të lartë (IAL) në vend gëzojnë autonomi dhe liri akademike. Në sistemin e arsimit të lartë përfshihen universitetet, akademitë, kolegjet profesionale, shkollat e larta dhe qendrat ndëruniversitare, të cilat ofrojnë programe të akredituara studimesh.

24. Në Republikën e Shqipërisë ka një sistem të mirë shëndetësor, me një infrastrukturë të gjerë të institucioneve që ofrojnë ndër të tjera edhe shërbime të kujdesit ndaj nënës. Të gjitha gratë shtatzëna marrin kujdesin para lindjes nga një ofrues i kualifikuar, të paktën një herë gjatë shtatzënisë. Niveli i vdekshmërisë së fëmijëve nën 5 vjeç⁷ ka qenë 22 vdekje për çdo 1,000 lindje, çka nënkupton se afërsisht 1 në 45 fëmijë të lindur në vend gjatë kësaj periudhe ka vdekur përpara se të bëhej pesë vjeç. Sidoqoftë, vdekshmëria foshnjore është 18 vdekje për 1,000 lindje, çka tregon se shumica e vdekjeve në fëmijërinë e hershme ka ndodhur në vitin e parë të jetës. Referuar burimeve të Anketës ADHS 2008-2009, normat e vdekshmërisë së të porsalindurve dhe postnatale janë përkatësisht 11 dhe 7 për çdo 1,000 lindje.

25. Të dhënat e INSTAT-it tregojnë se vdekshmëria amtare në çdo 100.000 gra të moshës 15-49 vjeç ka ardhur duke u ulur (nga 1 që ishte në vitin 2002 ka zbritur në 0.6 për vitin 2007). E njëjta tendencë vihet re edhe për nivelet e vdekjeve për çdo 100.000 lindje të gjalla, të cilat, referuar të njëjtës periudhë, kanë zbritur nga 21.2 në 14.7. Vdekjet gjatë abortit regjistrohen në nivelin zero.

Statistikat tregojnë se 99% e femrave dhe pothuajse 100% e meshkujve të moshës 15-49 vjeç dinë së paku një metodë të planifikimit familjar. Përdorimi metodave të planifikimit familjar rritet në përpjesëtim të drejtë me nivelin e arsimit. Niveli i ulët aktual i infeksionit HIV në Shqipëri ofron mundësinë për ndërhyrje të hershme dhe për parandalimin e përhapjes së mëtejshme të sëmundjes. Shumica e rasteve me HIV në Shqipëri kanë qenë diagnostikuar midis grave dhe burrave në grupmoshën 25-44 vjeç. Megjithatë prej vitit 2000, një përqindje në rritje e grave janë infektuar me HIV/AIDS.

26. Dhjetë shkaqet më të mëdha të vdekjeve në vend, të konstatuara nga statistikat ditore të vdekjeve, janë: a) aksidentet; b) vrasjet/vetëvrasjet; c) helmimet; d) traumat; e) përdorimi i duhanit; f) abuzimi me pijet alkoolike; g) kanceri; h) hipertensioni; i) SIDA/HIV; j) problemet lidhur me marrjen e kujdesit shëndetësor.

A. iii/2. Treguesit ekonomikë

27. Niveli kombëtar i varfërisë në Republikën e Shqipërisë ka ardhur vazhdimisht duke u ulur.

⁷ Informacioni i referohet viteve 2004-2008

Të dhënat deklarojnë se në vitin 2002, ky tregues përfshinte 25,4% të popullsisë së përgjithshme, ndërsa për periudhën kohore 2005-2010 ky nivel është ulur ndjeshëm në masën 12,4%.

28. Të dhënat e raportuara nga INSTAT deklarojnë një rritje të nivelit të punësimit në vend⁸, pavarësisht faktit se kjo rritje prek kryesisht sektorin privat (12%). Ndërsa në sektorin shtetëror vihet re një ulje e nivelit të punësimit me të njëjtën përqindje (12%), nëse do t'i referoheshim dy viteve: 2002 dhe 2009. Referuar të njëjtit burim, rezultoi se niveli i papunësisë për periudhën 2003-2009 ka pësuar një ulje me 2,1%. Raporti i të papunëve meshkuj/femra mbetet pothuajse i pandryshuar në vite. Vendin kryesor në strukturën e të papunëve, sipas nivelit arsimor e zënë të papunët me arsim minimal fillor dhe tetëvjeçar (54%). Punëkërkuetit me arsim të mesëm përbëjnë 44%, ndërsa ata me arsim të lartë zënë 2% të këtij treguesi. Personat me arsim minimal apo pa arsim janë kryesisht të punësuar në sektorin informal.

29. Tregu shqiptar i punës vuan akoma një nivel të lartë të tregut informal. Për më tepër ka pak lëvizshmëri ndërmjet sektorit informal dhe atij formal. Nivelet e punësimit në sektorët shtetëror (18,1%) dhe privatë (81,9%) të vendit, tregojnë për një përqindje më të lartë të këtij të fundit⁹. Struktura e punësimit reflekton faktin që ekonomia është e dominuar nga sektori bujqësor (bujqësi- 44.5%; tregti - 11.7%; industria përpunuese - 7.1%; ndërtim - 8.4%).

30. Raporti i forcave të punës i regjistruar në sindikatat profesionale është afërsisht 170 mijë persona.

31. Prodhimi i brendshëm bruto për frymë është një tjetër tregues që ka pësuar një rritje të konsiderueshme gjatë periudhës së viteve 2005-2009. Niveli i PBB-së për frymë në vitin 2009 ka pësuar një rritje prej 98.700 lekë (ALL), ose 38% më shumë se në vitin 2005. Sipas përcaktimeve kategorizuese të INSTAT, shpenzimet për konsum në një familje shqiptare bëjnë pjesë në grupin “indekse mesatare të çmimeve të konsumit”. Shpërndarja e shpenzimeve të konsumit familjar për grupet ushqim, strehim, shëndetësi dhe arsim zënë mesatarisht 58,76% të buxhetit të familjeve mesatare me 2 fëmijë dhe 63,65% të buxhetit të familjeve me një prind (tab.9/aneksi 3).

32. Paga bazë minimale mujore, për punonjësit në shkallë vendi, e detyrueshme për zbatim nga personat fizikë dhe juridikë, qofshin këta shtetërorë apo privatë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 566, datë 14.7.2010 është rritur në shumën 19.000 lekë (tab.10/aneksi 3). Të ardhurat në Buxhetin e Shtetit për vitin 2009 kanë pasur një rritje në masën 46%, krahasuar me vitin 2005. Rreth 90.4% e totalit të këtyre të ardhurave në vitin 2009 përbëhej nga të ardhurat tatimore. Zëri “Shpenzime” në Buxhetin e Shtetit, referuar të njëjtës periudhë ka pasur një rritje me 63%.

33. Burimet bazë për prodhimin e energjisë në vend janë: qymyri, gazi natyral, nafta bruto dhe nënproduktet e saj, drutë e zjarrit, energjia elektrike etj. Vendin e parë në shfrytëzimin e këtyre burimeve e zë nafta bruto dhe nënproduktet e saj, për të vazhduar më pas me energjinë elektrike, drutë e zjarrit, gazin natyror dhe qymyrgurin. Konsumi final i burimeve energjetike në vend përballohet nga vetë prodhimi i tyre, i cili ka regjistruar si periudhën më të mirë prodhuese vitet 2004-2005 (tabela 13/aneksi 3).

A. iii/3. Treguesit kulturorë

34. Falë karakteristikave të veçanta të relievit shqiptar dhe politikave orientuese të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, turizmi shqiptar vitet e fundit ka tërhequr vëmendjen e shumë vizitorëve të huaj. Statistika të këtij institucioni deklarojnë se gjatë periudhës janar-dhjetor 2009, numri i turistëve që kanë hyrë në territorin shqiptar është rritur afërsisht 2,4 herë më shumë se në vitin 2005.

35. Destinacionet më të vizituara nga të huajt janë: riviera dhe alpet shqiptare, parqet dhe qendrat arkeologjike, muzetë historikë, parqet kombëtare natyrore etj. Qendra arkeologjike e Butrintit, së bashku me qytetet e Gjirokastrës dhe Beratit janë shpallur nga UNESCO si qendra të trashëgimisë kulturore botërore. Monumentet shqiptare të antikitetit përbëjnë një pasuri të veçantë në trashëgiminë kulturore shqiptare. Përmenden këtu: tumat ilire, fortifikimet e qyteteve antiko-mesjetare të Lezhës dhe Beratit, varret monumentale të Selcës, kisha e Mesopotamit dhe Pojanit, qytetet muze të Beratit dhe

⁸ Shifrat i referohen periudhës kohore 2002-2009

⁹ Burimi: INSTAT, Anketa e Forcave të Punës 2008



Gjirokastrës, xhamia e Et'hem Beut dhe teqeja Helvetive e Beratit, pikturat murale të Onufrit dhe David Selenicasit, si dhe 8 (tetë) muzetë historikë dhe etnografikë, që ndodhen në qytetet e Tiranës, Krujës, Korçës dhe Beratit.

B. Struktura kushtetuese, politike dhe gjyqësore e shtetit

B. i Qeverisja

36. Parashikuar në nenin 1 të Kushtetutës^{10,11} së vendit, rendi kushtetues në Republikën e Shqipërisë është përcaktuar ai i formës “Republikë parlamentare”. Referuar të njëjtës dispozitë, Shqipëria përcaktohet si “shtet unitar dhe i pandashëm, qeverisja e të cilit bazohet në zgjedhjet e lira, të barabarta, të përgjithshme dhe periodike”. Sistemi i qeverisjes në vend bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor (neni 7 i Kushtetutës). Veprimtaria e Shtetit orientohet nga parimi i zbatimit të së drejtës. Legjislatori shqiptar e ka konsideruar Kushtetutën si një përmbledhje garancish për respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, dhe e vendos atë, përveçse rasteve kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe, në pozicionin më të lartë të hierarkisë ligjore në vend¹².

B. ii Pushteti legjislativ

37. Pushteti ligjvënës ushtrohet në Kuvendin e Shqipërisë. Ai përbëhet prej 140 deputetësh, të cilët paraqiten në nivel zone zgjedhore vetëm nga partitë politike, koalicionet e partive, si dhe nga zgjedhësit. Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë zhvillohen një herë në katër vjet (neni 65, 68). Të drejtën për të propozuar projektligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës. Kuvendi vendos për miratimin e ligjeve me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveçse rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar (nenet 78/1 dhe 81). Një ligj quhet i shpallur nëse pas miratimit nga Kuvendi ai dekretohet nga Presidenti i Republikës. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë. Dekreti i Presidentit për rishqyrtim e humbet fuqinë, nëse kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

B. iii Presidenti i Republikës

38. Presidenti i Shqipërisë është Kryetari i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit. Ai i propozohet Kuvendit nga një grup prej jo më pak se 20 deputetësh dhe zgjidhet prej tij me votim të fshehtë. Mandati i tij është 5-vjeçar dhe me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Për zgjedhjen e Presidentit Kuvendi zhvillon deri në pesë raunde votime. Presidenti zgjidhet në votimin e parë, të dytë ose të tretë kur një kandidat merr jo më pak se tri të pestat e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në votimin e katërt dhe të pestë zgjidhet Presidenti kandidati që siguron më shumë se gjysmën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit¹³. Në rast se edhe pas votimit të pestë asnjë kandidat nuk siguron shumicën e kërkuar, ose kur pas votimit të katërt pa sukses nuk paraqitet asnjë kandidat e re, Kuvendi shpërndahet. Zgjedhjet e reja zhvillohen brenda 45 ditëve nga shpërndarja e tij. Kuvendi pasardhës e zgjedh Presidentin e Republikës me shumicën e të gjithë anëtarëve të tij (neni 87 i Kushtetutës). Kur Presidenti i Republikës është në pamundësi të përkohshme për të ushtruar funksionet e tij ose kur vendi i tij mbetet vakant, Kryetari i Kuvendit zë vendin dhe ushtron kompetencat e tij.

39. Për sa i përket kompetencave të Presidentit janë trajtuar në Dokumentin e Parë Bazë të Shqipërisë si pjesë përbërëse e raporteve të shteteve palë (HRI/CORE/1/Add.124), konkretisht paragrafi 62 i këtij dokumenti.

B. iv Pushteti ekzekutiv

40. a. Këshilli i Ministrave, si organi më i lartë i pushtetit ekzekutiv, përbëhet nga Kryeministri, Zëvendëskryeministri dhe Ministrat. Kryeministri, i cili është njëkohësisht Kryetar i Këshillit të Ministrave, emërohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e partisë ose koalicionit të partive që

¹⁰ Miratuar me ligjin nr. 8417/1998 dhe shpallur me dekretin nr. 2260/1998 të Presidentit të Republikës

¹¹ Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007 dhe ligjin 9904, datë 21.4.2008

¹² Nenet 166 dhe 122 të Kushtetutës

¹³ Procedura e zgjedhjes së Presidentit në votimin e katërt dhe të pestë me shumicën e thjeshtë të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, u sanksionua me amendimin që iu bë nenit 87 të Kushtetutës me ligjin nr. 9404, datë 21.4.2008, pasi më parë përcaktohej se në të pesta raundet e votimit President zgjidhej kandidati që merrte jo më pak se tri të pestat e votave pra shumicën e cilësuar.

ka shumicën në Kuvend. Brenda 10 ditëve nga zgjedhja e tij, Kryeministri i paraqet për miratim Kuvendit programin politik të Këshillit të Ministrave së bashku me përbërjen e tij.

41. Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore. Aktet me të cilat vepron ky organ janë të formës “vendime” dhe “udhëzime”. Ai i merr vendimet me propozim të Kryeministrit ose ministrit përkatës. Në raste nevojë dhe urgjence Këshilli i Ministrave mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte i dërgohen menjëherë për miratim Kuvendit, dhe nëse nuk miratohen brenda 45 ditëve ato e humbasin fuqinë që nga nxjerrja e tyre.

42. b. Pushteti vendor në nivelin e njërive vendore përfaqësohet me qarqet, bashkitë dhe komunat. Ndarja administrative sipas këtyre konvencioneve konfigurohet në hartën e Shqipërisë me praninë e 12 qarqeve, 65 bashkive dhe 308 komunave. Organi ekzekutiv i bashkisë ose komunës është Kryetari i bashkisë ose komunës. Së bashku me përfaqësuesit e këshillave bashkiakë ose komunave, ata zgjidhen nëpërmjet zgjedhjeve të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.

43. Organi përfaqësues i qarkut është Këshilli i Qarkut. Ai drejtohet nga Prefekti, i cili është dhe përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave në pushtetin vendor. Bashkitë dhe komunat delegojnë anëtarë në këshillin e qarkut në përpjesëtim me popullsinë e tyre, por për çdo rast të paktën një anëtar.

44. Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore. Mbështetur në këto parime, njësitë e qeverisjes vendore konsiderohen si persona juridikë dhe administrojnë një buxhet të pavarur, i cili krijohet në mënyrën e parashikuar me ligj. Në kompetencat e këshillave të qarkut, bashkive dhe komunave përfshihen: rregullimi dhe administrimi në mënyrë të pavarur i çështjeve brenda juridiksionit të tyre; vendosja e taksave vendore dhe administrimi i të ardhurave të krijuara nga njësitë vendore; caktimi i rregullave për organizimin dhe funksionimin e tyre etj.

B. v Pushteti gjyqësor

Gjykatat

45. Në nenin 7 të Kushtetutës parashikohet se “Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”, duke garantuar në këtë mënyrë ndërtimin e një shteti të së drejtës dhe demokratik. Mbështetur në nenin 42 të Kushtetutës, liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, apo dhe në rastin e akuzave të ngritura kundër tij ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm dhe nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në nenin 135 parashikohet se pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga gjykatat e apelit, si dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.

46. Që prej vitit 2004, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda zhvillon veprimtarinë e saj, sipas ligjit nr. 9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda”. Arsyet e krijimit të kësaj gjykate ishin rritja e efektivitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, si dhe përmirësimi i gjykimit të këtyre çështjeve penale. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka në kompetencën e saj tokësore të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe si qendër të ushtrimit të veprimtarisë së saj Tiranën. Objekt i punës së kësaj gjykate janë një sërë veprash penale të parashikuara nga nenet e Kodit Penal, duke përfshirë edhe rastet kur ato janë kryer nga subjekte që janë në kompetencë të gjykatës ushtarake ose janë kryer nga të miturit.

47. Neni 145 i Kushtetutës ka përcaktuar se gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Pavarësia e sistemit gjyqësor garantohet edhe nëpërmjet një strukture të pavarur, e cila është kompetente për emërimin, transferimin apo dhe shkarkimin e gjyqtarëve.

48. Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet nga Presidenti i Republikës, i cili është njëkohësisht edhe Kryetar i këtij institucioni, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë, 3 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, 9 gjyqtarë të të gjitha niveleve, të cilët zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.

49. Gjykata Kushtetuese është një institucion i rëndësishëm në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Kjo gjykatë garanton respektimin e Kushtetutës, bën interpretimin përfundimtar të saj, si dhe gjykimin



përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi janë ezauruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e tyre.

50. Me qëllim realizimin e pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe të një sistemi efektiv gjyqësor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, është miratuar një kuadër i plotë ligjor në lidhje me organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor (Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatat e Krimeve të Rënda).

Institucioni i Prokurorisë

51. Mbështetur në Kushtetutë, Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit në gjyq. Në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se prokurorët e ushtrojnë detyrën në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, si dhe kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të njeriut. Prokurorët janë të organizuar dhe ushtrojnë funksionet e tyre pranë sistemit gjyqësor si një organ i centralizuar. Ata emërohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm. Prokurori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin apo propozimin e Kuvendit.

52. Informacion më i detajuar lidhur me organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor (Gjykata e Lartë, Gjykata e Apelit, Gjykata e Shkallës së Parë, Gjykata Ushtarake, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokuroria dhe Gjykata Kushtetuese) është dhënë në Dokumentin e Parë Bazë të Shqipërisë (HRI/CORE/1/Add.124) konkretisht në paragrafët 66-78.

B. vi Sistemi elektoral

53. Procesi i zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë, si për Kuvendin ashtu dhe për organet e qeverisjes vendore, parashikohet nga Kushtetuta dhe rregullohet nga “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. E drejta aktive dhe pasive e votës, për të zgjedhur përfaqësuesit e popullit në Kuvend dhe organet vendore garantohet nga neni 45 i Kushtetutës së Shqipërisë. Përjashtohen nga kjo e drejtë shtetasit e deklaruar me anë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë si të paafte mendërisht. Të dënuarit që vuajnë dënimin me heqje lirie kanë të drejtë të ushtrojnë vetëm të drejtën pasive të zgjedhjes. Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

54. Kodi zgjedhor përcakton si “Subjekte zgjedhore” partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, si dhe kandidatët për kryetarë të organeve të qeverisjes vendore, të regjistruara në përputhje me këtë Kod. Zgjedhjet për Kuvendin apo për njësitë e qeverisjes vendore janë periodike dhe zhvillohen njëherësh në të gjithë territorin e vendit. Data e zhvillimit të tyre vendoset me dekret të Presidentit të Republikës.

55. Institucioni përgjegjës për përgatitjen, zhvillimin, administrimin dhe shpalljen e rezulttit të zgjedhjeve për në Kuvendin e Shqipërisë, për organet e qeverisjes vendore dhe referendumet është Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV). Në përfundim të procesit të numërimit të votave KQZ shpall me vendim rezultatin e zgjedhjeve për çdo zonë zgjedhore ose në shkallë vendi. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit Zgjedhor, brenda 5 ditëve nga shpallja e rezulttit të KQZ-së. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit Kolegji Zgjedhor vendos për pushimin e gjykimit, gjykimin e çështjes në themel ose detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim. Pas përfundimit të procesit të ankimit KQZ bën shpalljen e rezultateve dhe përllogarit ndarjen e mandateve.

56. Kushtetuta shqiptare e vitit 1998 në nenin 64/1 (Kuvendi, zgjedhja dhe afati) parashikonte një sistem zgjedhor mazhoritar-proporcional të përzier. Sipas kësaj dispozite Kuvendi përbëhej nga 140 deputetë, 100 prej të cilëve zgjidheshin në zona njëemërore (me numër të përafërt zgjedhësish) dhe 40 deputetët e tjerë zgjidheshin nga listat shumëemërore të partive dhe koalicioneve të partive, sipas renditjes në to. Partitë politike që merrnin më pak se 2.5% dhe koalicionet e partive që merrnin më pak se 4% të votave të vlefshme në të gjithë vendin në raundin e parë të zgjedhjeve, nuk përfitonin nga lista shumëemërore përkatëse.

57. Ky sistem zgjedhor u zbatua për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të viteve 2001 dhe 2005. Ndryshimet kushtetuese që ndodhën në vitet 2007 dhe 2008 përcaktuan një sistem tjetër zgjedhor

për Shqipërinë, i cili u zbatua në zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2009. Neni 64/1, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Kuvendi i Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur me sistem proporcional me zona zgjedhore shumëëmërore”.

B. vii Indikatorët mbi sistemin politik

58. Sistemi i lirë demokratik në Republikën e Shqipërisë garantohet nga neni 9 i Kushtetutës së vendit dhe neni 3 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”. Referuar dispozitës së cilësuar në Kushtetutë, kjo e fundit lejon krijimin e partive politike dhe organizatat e tjera në vend, përveçse rasteve kur këto subjekte “mbështeten në metoda totalitariste, përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit ose për të ndikuar në politikën shtetërore, si edhe ato me karakter të fshehtë”. Në një rast të tillë ato konsiderohen të ndaluara me ligj.

59. E njëjta garanci politike sigurohet në nenin 3 të ligjit, në të cilin partitë politike shqiptare konsiderohen “pjesë e një sistemi të lirë e demokratik qeverisës në vend.”.

B. viii Organizatat jofitimprurëse

60. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejtën e kujt do për t’u organizuar kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm (neni 46). Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurave të parashikuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 8788/2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar. Në Kodin Civil organizatat, shoqatat, shoqëritë, fondacionet, si edhe entet e tjera me karakter privat përcaktohen si persona juridikë privatë. Këto subjekte juridike kanë për objekt arritjen e një qëllimi të ligjshëm me anë të destinimit të pasurisë në të mirë dhe në interes publik. Në të njëjtën linjë me KC, neni 4 i ligjit të mësipërm i garanton të drejtën që çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, të drejtën për të themeluar një organizatë jofitimprurëse, të jetë anëtar i saj ose të marrë pjesë në organet drejtuese ose personelin administrativ të saj.

61. Shoqatat dhe fondacionet e fitojnë cilësinë e personit juridik nga dita e regjistrimit të tyre në gjykatë. Të njëjtës procedurë i nënshtrohen edhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja. Kur objekti dhe qëllimi i organizatës jofitimprurëse që kërkon të regjistrohet është i paligjshëm, gjykata ka të drejtë të mos pranojë kërkesën për regjistrim. Kundër këtij vendimi subjekti i interesuar mund të bëjë ankim në Gjykatën e Apelit të Tiranës. Kur organizata jofitimprurëse e regjistruar rregullisht, angazhohet në veprimtari antikushtetuese apo të paligjshme, gjykata me kërkesë të organit kompetent shtetëror mund të vendosë shpërndarjen e saj (neni 45 i ligjit 8789/2001). Krijimi i shoqatave antikushtetuese shoqërohet me sanksionin përkatës të përcaktuar në mënyrë eksplicite në nenin 224 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon se: “Krijimi apo pjesëmarrja në parti, organizata apo shoqata që synojnë përmbysjen me dhunë të rendit kushtetues, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet...”. Organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë të realizojnë të ardhura nga kuotizacione, fonde, grande dhe donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendase ose të huaja, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe pasuritë në pronësi të organizatës jofitimprurëse. Lehtësimi dhe përjashtimi nga detyrimet fiskale të organizatave jofitimprurëse parashikohet në nenin 40 të ligjit nr. 8788/2001. Sipas kësaj dispozite të ardhurat e realizuara nga dhurimet dhe kuotat e anëtarësisë përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat. Për të gjitha të ardhurat e tjera të realizuara jashtë kuadrit të veprimtarisë së saj, organizata konsiderohet fitimprurëse dhe i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat.

B. ix Administrimi i drejtësisë dhe treguesit e krimit

62. Drejtësia në Republikën e Shqipërisë administrohet nga Gjykata, Prokuroria e Policia e Shtetit, i cili është një organ në varësi të Ministrisë së Brendshme. Në mbështetje të ligjit nr. 8588/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë është 17 gjyqtarë. Numri i gjyqtarëve në gjykatat e rretheve gjyqësore dhe në gjykatat e apelit bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr. 6265/2009 “Për caktimin e numrit të Gjyqtarëve për çdo Gjykatë të Shkallës së Parë dhe të Apelit”, është 374 gjyqtarë. Numri i përgjithshëm i prokurorëve që ushtrojnë veprimtarinë në rrethet gjyqësore në vend, përcaktuar edhe me dekretin nr. 3477/2002 të Presidentit të Republikës, është 330. Emëruar në detyrë nga Prokurori i Përgjithshëm, në strukturat e Prokurorisë ushtrojnë detyrat e tyre funksionale edhe 149 oficerë të policisë gjyqësore, me formim arsimor “juristë”.



63. Për sa i përket treguesve të krimit, mbështetur në informacionin e përpunuar nga statistikat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën kohore 2002-2010 (6-mujori i I-rë), vihet re një rënie e rasteve të krimit për veprën penale të “vrasjes me dhunë”. Kështu, numri i vrasjeve për 100.000 banorë për vitin 2002 ishte 4.75 vrasje, për vitin 2006 ato zbresin në nivelin 2.8 vrasje dhe për gjashtëmujorin e parë të 2010 ky numër reduktohet në 1.2 vrasje. Referuar të njëjtit burim, për të njëjtën periudhë, vihet re gjithashtu një rënie e numrit të personave të arrestuar/burgosur për ushtrim dhune ose krime të tjera. Nëse në vitin 2002, numri i personave të arrestuar (për 100.000 banorë) për veprën penale të vrasjes ishte 6, në vitin 2010 (6-mujorin e I-rë) ky numër zbritet në 1.25 persona.

64. Statistikat për veprën penale të vjedhjes, referuar të njëjtës periudhë, ruajnë të njëjtën tendencë. Rastet e vjedhjeve të regjistruara (për 100.000 banorë) në vitin 2002 deklaroheshin në shifrën 29.08, ndërsa në pjesën e parë të vitit 2010 ky numër reduktohet në shifrën 22.9 vjedhje.

65. Numri i personave të arrestuar për trafikim të qenieve njerëzore (për 100.000 banorë) për vitin 2010 ka rënë në shifrën 0.78, nga 6.9 persona të arrestuar që rezultojnë në vitin 2002. Lidhur me rastet e arrestimit të personave për krimet seksuale, shifrat flasin për luhatje të numrit të autorëve të veprës penale të krimit. Nëse për vitin 2002 deklaroheshin 2.5 të arrestuar (për 100.000 banorë), në vitin 2006 ky tregues u rrit në nivelin 3.5 të arrestuar dhe në vitin 2010 vihet re një rënie e tij në shifrën 0.91.

66. Të dhënat statistikore të periudhës midis viteve 2005-2010, deklaruar nga Sektori i Mbrojtjes së të Miturve¹⁴ pranë Ministrisë së Brendshme, tregojnë për një ulje të numrit të fëmijëve të dëmtuar në veprat penale të krimeve kundër personit. Nëse në vitin 2005 numri i fëmijëve të dëmtuar është 388, në vitin 2008 ai zbritet në 280 të dëmtuar dhe në vitin 2010 ai reduktohet në vetëm 96 fëmijë të dëmtuar. Nga 6.5 raste që numëroheshin, në vitin 2009 numëroheshin vetëm 0.3 raste për 100.000 banorë. Gjatë 6-mujorit të I-rë të vitit 2011, rezultojnë të jenë dëmtuar nga vepra penale kundër personit 133 fëmijë. Numri i personave të kapur në tentativë për kalim të paligjshëm të kufirit në vitin 2008 numëronte 19.793 persona, ndërkohë që në vitin 2009 kjo shifër ra në numrin 18.229 persona. Gjithashtu, lidhur me figurën tjetër të veprës penale gjatë “Shfrytëzim të femrave për prostitucion, mbajtje e lokaleve për prostitucion dhe ushtrim prostitucioni”, gjatë vitit 2008 janë goditur shtatëmbëdhjetë grupe kriminale, në vitin 2009 nëntë grupe kriminale dhe në vitin 2010 gjashtë grupe kriminale.

67. Numri i personelit policor prej vitit 2002 deri në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 është reduktuar me gati 23%. Referuar statistikave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në vitin 2002 deklarohen 3.08 persona staf policor, ndërkohë për vitet 2006 dhe 2010 kjo shifër bie përkatësisht në nivelet 2.54 dhe 2.28 persona staf policor (për çdo 100.000 banorë)¹⁵.

68. Buxheti i sistemit të drejtësisë është pjesë e Buxhetit të Shtetit, hartimi dhe zbatimi i të cilit i nënshtrohet rregullave dhe procedurave ligjore për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit. Në bazë të kuadrit ligjor hartuar për këtë qëllim, Gjykatat, Prokuroria dhe Policia e Shtetit (pjesërisht) administrojnë një buxhet të pavarur. Referuar shifrave të deklaruara nga Ministria e Drejtësisë, buxheti i gjykatave për vitin 2009 ka pasur një rritje rreth 28%, krahasuar me buxhetin e vitit 2006. Ndërkohë që, për të njëjtat vite kjo rritje për shërbimin policor rezultojnë në masën 11.8%.

69. E drejta për të përfutur ndihmë/mbrojtje ligjore falas në procesin penal parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 31, paragrafi “ç”), Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë dhe ligjin nr. 10 039/2008 “Për ndihmën juridike”. Ndihma juridike e parashikuar sipas këtij kuadri ligjor i referohet të gjitha fazave të procedimit penal e rrjedhimisht shtrihet nga konsulenca ligjore në rajonin e policisë deri te përfaqësimi ligjor në gjykatë. Sipas statistikave të përfutur në mënyrë manuale nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, shifrat e personave të asistuar me ndihmë ligjore falas (në raport me numrin e personave të proceduar), rezultojnë në këto përqindje; viti 2006 - 8.87%; viti 2007 - 7.87%; viti 2008 - 12% dhe viti 2009 - 18.17%.

70. Garantuar në nenin 44 të Kushtetutës së RSh-së, e drejta e rehabilitimit ose zhdëmtimit në përputhje me ligjin, i njihet çdo personi të dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të

¹⁴ Ky sektor u krijua si një strukturë e posaçme pranë Ministrisë së Brendshme në vitin 2005

¹⁵ Për nxjerrjen e këtyre statistikave është përdorur numri i popullsisë, i llogaritur mbi bazën e projeksioneve të rritjes së numrit të popullsisë të vitit 1989 (nga INSTAT)

paligjshëm të organeve shtetërore¹⁶. Sipas nenit 1, të ligjit nr. 8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, të ndryshuar, organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet pasurore dhe jopasurore jashtëkontraktore, që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë, privatë, vendas a të huaj. Përgjegjësia jashtëkontraktore e organeve të administratës shtetërore rregullohet me dispozitat e këtij ligji dhe të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Në rastet kur dëmi ka të bëjë me cenimin e paprekshmërisë trupore, të shëndetit, të lirisë ose të personalitetit, shpërblimi bëhet në të holla, duke mbajtur gjithnjë parasysh rolin e të dëmtuarit në shkaktimin e dëmit.

71. Bazuar në dispozitën 13 të këtij ligji, në rastet e vdekjes, cenimit të paprekshmërisë trupore ose të shëndetit, si dhe në rastin e heqjes së padrejtë të lirisë, si rezultat i veprimeve/mosveprimeve të organeve të administratës shtetërore, të tretit, të cilit i dëmtuari ka qenë i detyruar t’i bëjë shërbime në shtëpi ose në punën e tij, i paguhet një dëmshpërblim në të holla për dëmin që i shkaktohet nga shërbimet e porealizuara. Në rast se është shkaktuar vdekja e një personi, për shkak të veprimeve/mosveprimeve të organeve të administratës shtetërore, këto të fundit janë të detyruara të dëmshpërblejnë shpenzimet e varrimit të atij që ka detyrimin ligjor për t’i paguar ato.

2. KUADRI I PËRGJITHSHËM PËR MBROJTJEN DHE PROMOVIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

C. Pranimi i normave të së drejtës ndërkombëtare

72. Shqipëria është e angazhuar, për sa i përket përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Shprehje e qartë e angazhimit të Shqipërisë është ratifikimi apo aderimi në pothuaj të gjitha konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në kuadër të OKB-së, si dhe një sërë instrumentesh ndërkombëtare. Në Republikën e Shqipërisë e drejta ndërkombëtare gëzon një pozitë të privilegjuar në raport me të drejtën e brendshme. Neni 5 i Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin që shteti shqiptar të zbatojë të drejtën ndërkombëtare. Në vijim, neni 122 i Kushtetutës ka përcaktuar se çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar nga Kuvendi bëhet pjesë e së drejtës së brendshme pasi botohet në Fletoren Zyrtare. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe aplikimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit të cilët nuk pajtohen me të. Gjithashtu edhe normat e nxjerra nga organizatat ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej saj.

Angazhimet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

73. Republika e Shqipërisë ka ratifikuar apo aderuar në një sërë konventash ndërkombëtare për të drejtat e njeriut: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike; Protokollin e Parë Opsional të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike; Protokollin e Dytë Opsional të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike për heqjen e dënimit me vdekje; Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore; Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave - CEDAW; Protokollin Opsional të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave; Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës; Protokollin Opsional të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës mbi Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionit të Fëmijës dhe Pornografisë së Fëmijës; Protokollin Opsional të Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, “Mbi përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura”; Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Punonjësve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre; Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukjet me Forcë; Konventat e Gjenevës; Statusi i Romës mbi Gjykatën Penale Ndërkombëtare; Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

74. Shqipëria ka nënshkruar një numër të konsiderueshëm të Konventave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe UNESCO-s. Gjithashtu Shqipëria është palë në Konventën Europiane

¹⁶ Nuk disponohen të dhëna zyrtare mbi raportin e viktimave që janë shpërblyer pas kryerjes së dënimit në institucionet përkatëse.



“Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”; Protokollet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 11, 12, 13, 14 të kësaj Konvente; Konventa Kuadër “Për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare”, “Karta Sociale Europiane”; Konventa Europiane për Parandalimin e Torturës, Trajtimeve apo Dënimeve Çnjerëzore, Degraduese, si dhe Konventa të tjera të Këshillit të Europës.

75. Informacion më i detajuar lidhur me instrumentet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë jepet në aneksin nr. 2, pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

D. Kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar

D. a. Kuadri Kushtetues

76. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 (të ndryshuar) trajton parimet bazë të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në preambulën e saj, ndër të tjera është parashikuar se “Populli shqiptar... me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar liritë dhe të drejtat e njeriut, me frymën e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe personalitetit njerëzor, si dhe për prosperitetin e të gjithë kombit, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit”.

77. Në nenin 3 të Kushtetutës parashikohet se “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat e liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me minoritetet, janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë e t’i mbrojë”. Në vijim, në më shumë se ¼ e neneve të Kushtetutës trajtohen problemet mbi të drejtat e njeriut dhe institucionet të cilat kanë funksion të drejtpërdrejtë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

78. Në pjesën e dytë të Kushtetutës “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, në kreun e parë të kësaj pjese trajtohen parimet e përgjithshme (nenet 15-20), në të cilin parashikohet shprehimisht se të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut të cilat janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik shqiptar. Si detyrim kushtetues, të gjitha institucionet dhe organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Kushtetuta përcakton se të drejtat dhe liritë themelore dhe detyrimet e parashikuara vlejnë njëlloj si për shtetasit shqiptarë ashtu edhe për të huajt e për personat pa shtetësi.

79. Kushtetuta ka parashikuar si rast përjashtimor kufizimin e të drejtave të njeriut. Kufizimi i lirive dhe të drejtave të njeriut mund të vendoset vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave e në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, si dhe duhet të jenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

80. Kushtetuta u garanton një mbrojtje të veçantë minoriteteve kombëtare. Minoritetet kombëtare ushtrojnë në barazi të plotë përpara ligjit të drejtat dhe liritë e tyre. Ato kanë të drejtë të shprehin lirisht pa u ndalur as detyruar përkatësinë e tyre etnike, kulturore, fetare e gjuhësore. Ato kanë të drejtë t’i ruajnë e zhvillojnë ata, të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën e tyre amtare, si dhe të bashkohen në organizata e shoqata për mbrojtjen e interesave dhe identitetit të tyre.

81. Në kreun e dytë të pjesës së dytë të Kushtetutës parashikohen dispozita të veçanta për respektimin dhe promovimin e lirive dhe të drejtave vetjake, politike, ekonomike sociale dhe kulturore. Në këtë pjesë konfirmohet mbrojtja me ligj e jetës, garantimi i lirisë së shprehjes, i lirisë së shtypit, radios dhe televizionit. Garantohet gjithashtu liria e ndërgjegjes dhe e fesë, e drejta e informimit. Në të përcaktohet se askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës, apo dhe punës së detyruar. Në vijim Kushtetuta garanton lirinë e individit, si dhe parimet që sigurojnë këtë liri. Kushtetuta parashikon edhe rastet se kur kjo liri mund të kufizohet, si dhe trajton në mënyrë të detajuar garancitë procedurale të cilat sigurojnë lirinë e individit (nenet 27-35). Kushtetuta garanton fshehtësinë e korrespondencës, paprekshmërinë e banesës, të drejtën e zgjedhjes së vendbanimit, ndalimin e dëbimit për shtetasit shqiptarë, si dhe garantimin e pronës private.

82. Në kreun e tretë të pjesës së dytë të Kushtetutës trajtohen liritë dhe të drejtat politike konkretisht: e drejta e çdo shtetasi i cili ka mbushur moshën 18 vjeç për të zgjedhur e për t’u zgjedhur, e

drejta e çdo individi për t'u bashkuar në një organizatë e shoqatë e drejta për t'u tubuar apo dhe e drejta për të drejtuar ankesa, vërejtje dhe ankesa organeve publike.

83. Në kreun e katërt të pjesës së dytë trajtohen liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore. Puna njihet si mjeti i vetëm me anë të së cilit individi fiton mjetet e jetesës së tij. Nga ana tjetër individi i njihet e drejta për t'u bashkuar në një organizatë sindikale, e drejta për grevë, e drejta për sigurime shoqërore. Në këtë kre trajtohet edhe e drejta për martesë dhe krijimin e familjes. Mbrojtje të veçantë gëzojnë gratë dhe fëmijët. Arsimi i detyrueshëm dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.

D. b Kuadri i brendshëm ligjor

84. Në shërbim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave apo dhe institucioneve të tjera shtetërore, janë miratuar një korpus i tërë aktesh normative, i cili ka si qëllim garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Disa prej këtyre akteve janë: Kodi Penal (1995-i ndryshuar); Kodi i Procedurës Penale (1995-i ndryshuar); Kodi Civil (1994-i ndryshuar); Kodi i Procedurës Civile (1995-i ndryshuar); Kodi i Punës (1995-i ndryshuar); Kodi i Procedurave Administrative (1999); Kodi i Familjes (2003), Kodi Zgjedhor (2008); ligji “Për statusin e invalidit të punës”(1994); ligji “Për sistemin arsimor parauniversitar” (1995); ligji “Për statusin e jetimit” (1996); ligji “Për statusin e të verbrit” 1996; ligji “Për të drejtën e tubimeve” (1996); ligji “Për shtypin” (1997); ligji “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat” (1998); ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” (1998-i ndryshuar); ligji “Për ekzekutimin e vendimeve penale” (1998), ndryshuar me ligjin nr. 10 024, datë 27.11.2008; ligji “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” (1998-i ndryshuar); ligji “Për Avokatin e Popullit” (1999-i ndryshuar); ligji “Për partitë politike” (2000); ligji “Për funksionimin e Policisë Gjyqësore” (2000-i ndryshuar); ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (2001-i ndryshuar); ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” (2001-i ndryshuar); ligji “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” (2002); ligji “Për profesionin e avokatit” (2003-i ndryshuar); ligji “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë” (2009)¹⁷; ligji “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore”(2005-i ndryshuar); ligji “Për masat ndaj dhunës në familje”(2006); ligji “Për Policinë e Shtetit”(2007), ligji “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”(2010)¹⁸; ligji “Për funksionimin e pushtetit gjyqësor” (2008); ligji “Për shërbimin e përmbartimit gjyqësor privat” (2008); ligji “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Brendshme” (2008); ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (2008); ligji “Për të huajt” (2008); ligji “Për policinë e burgjeve” (2008); ligji “Për ndihmën juridike” (2008); ligji “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it” (2008); ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” (2008); ligji “Për shëndetin publik” (2009), ligji “Për gjendjen civile” (2009); ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (2010); ligji “Për të drejtat e fëmijës”(2010); ligji nr. 10 295, datë 1.7.2010 “Për faljen”; ligji nr. 10 385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” (i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 9090, datë 26.6.2003); ligji nr. 10 428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara që janë pjesë e sistemit ligjor të brendshëm, legjislacioni shqiptar, i cili po përmirësohet vazhdimisht, garantojnë respektimin dhe zbatimin në praktikë të të drejtave dhe lirive të njeriut.

D. c Institucionet dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

85. Ndër institucionet kryesore që ofrojnë mbrojtjen e barabartë përpara ligjit dhe pa asnjë dallim të shtetasve në Republikën e Shqipërisë është Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues, i cili e ushtron veprimtarinë e tij, në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve, të cilat mund të cenohen nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Institucioni i Avokatit të Popullit i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe

¹⁷ Ligji “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë” i vitit 2009, ka shfuqizuar ligjin e mëparshëm nr. 9205, datë 15.3.2004.

¹⁸ Ky ligj ka ndryshuar ligjin “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve” të vitit 2007.



pavarësisë e ushtron veprimtarinë e tij në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, të parashikuara në dispozita kushtetuese dhe në ligje, si dhe ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike.

86. Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 11.3.2004 “Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve”), ka si qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së personave që u përkasin minoriteteve kombëtare në jetën publike të vendit, bashkëpunimin me organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, me organizatat dhe shoqatat që trajtojnë çështjet e minoriteteve, për përmirësimin e standardeve në respektimin e të drejtave të minoriteteve në Shqipëri. Ai propozon masa konkrete për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe arsimor të minoriteteve, duke kontribuar për përmirësimin e gjendjes së personave që u përkasin minoriteteve.

87. Strukturat e Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit janë të angazhuara maksimalisht në respektimin e të drejtave të njeriut, duke marrë masat përkatëse për këtë qëllim. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe strukturat vartëse të saj vlerësojnë dhe zgjidhin me vëmendje çdo kërkesë, kallëzim apo ankim që lidhet me zbatimin në praktikë të lirive dhe të drejtave të njeriut në të gjithë vendin. Në këtë kontekst konstatohet se nuk janë evidente rastet e diskriminimit për shkak të identitetit etnik, kulturor, gjuhësor, fetar, racor etj. Tregues pozitiv i mungesës në Shqipëri të qëndrimeve, opinionëve dhe shfaqjeve me natyrë raciale, diskriminuese dhe ksenofobe është dhe fakti se vitet e fundit ka pasur një numër shumë të vogël procedimesh penale për veprat penale me natyrë raciale (nenet 253, 265 dhe 266 të Kodit Penal).

88. Inspektorati Shtetëror i Punës, siguron zbatimin e legjislacionit të punës nga subjektet shtetërore dhe private, duke përfshirë edhe kontrollin e punës së të miturve.

89. Komiteti Ndërmintor për romët kryesohet nga Ministri i Punës me cilësinë e Kryetarit. Anëtarë të këtij Komiteti janë përfaqësues të Ministrive të linjës si: përfaqësues nga MPCSSHB-ja, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Brendshme dhe OJF-të e ndryshme.

90. Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore i kryesuar nga Ministri i Brendshëm, është përgjegjës për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit. Në dhjetor të vitit 2008 është krijuar Taks Forcë Kombëtare kundër Trafikimit.

91. Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (e krijuar në vitin 2005) koordinon punën ndërmjet ministrive të ndryshme në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe të gjithë strukturave të tjera shtetërore dhe jo shtetërore si në nivel kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar. Pjesë e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar është Njësia Antitrafik.

92. Komitetet Rajonale të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, janë krijuar në vitin 2006 në 12 qarqet e vendit, kanë si qëllim mbikëqyrjen dhe bashkërendimin e veprimeve qeveritare dhe joqeveritare, në nivel rajonal/vendor, për parandalimin e fenomenit të trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave të mundshme të trafikimit. Në nivelin administrativ, funksionojnë struktura të posaçme në polici për të luftuar krimin e organizuar dhe trafiqet e paligjshme.

93. Grupi i Punës Ndërinstitucional (GPNI), është ngritur në mbështetje të ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri” dhe me urdhër të Ministrit të Punës nr. 2498, datë 16.12.2008, si grup këshillimor në sigurimin e statistikave dhe indikatorëve gjinorë në mbështetje të politikave të monitorimit të barazisë gjinore në Shqipëri.

94. Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, është ngritur në përputhje me ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

95. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore, është organ këshillimor për politikën gjinore i ngritur me urdhrin nr. 3, datë 8.1.2009 të Kryeministrit “Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore”, në zbatim të ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Ky Këshill drejtohet nga ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe në përbërje ka 9 zëvendësministra dhe 3 anëtarë përfaqësues së shoqërisë civile. Përveç detyrave të tjera, Këshilli kujdeset për të siguruar integrimin gjinor në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore.

96. Këshilli Kombëtar për çështjet e aftësisë së kufizuar, i krijuar në vitin 2005, garanton mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi dhe integrimin e tyre në të gjitha fushat.

97. Sekretariati teknik për personat me aftësi të kufizuar, (krijuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 40, datë 23.3.2006), pranë MPÇSSHB-së. Ky sekretariat monitoron zbatimin e strategjisë kombëtare të personave me aftësi të kufizuara (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 7.1.2005) dhe planin e saj të veprimit.

98. Drejtoria e Politikave të Shërbimeve Sociale dhe Sigurimeve Shoqërore ka si mision formulimin dhe zhvillimin e politikave, legjisllacionit dhe strategjive për mbështetjen e individëve, familjeve, grupeve dhe komuniteteve në nevojë me pagesa në kesh dhe shërbime shoqërore në nivel komunitar me qëllim parandalimin e diskriminimit dhe përjashtimit social, duke nxitur rehabilitimin, integrimin dhe përfshirjen e tyre në jetën shoqërore, si dhe mbrojtjen nga skema e sigurimeve shoqërore.

99. Drejtoria e Monitorimit të Strategjive Ndërsektoriale është ngritur dhe funksionon në MPÇSSHB, që nga viti 2009 dhe ka nën autoritetin e saj Sekretariatit Teknik për Romët dhe Sekretariatit Teknik për Personat me Aftësi të Kufizuar. Funksioni i kësaj drejtorie ka të bëjë me monitorimin e objektivave të strategjive ndërsektoriale që udhëheq MPÇSSHB-ja, me qëllim vlerësimin e impaktit të politikave të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale të grupeve vulnerabël.

100. Duke filluar prej vitit 2007 në nivel qendror funksionon sektori për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje, (pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit). Në nivel rajonal në Drejtoritë e Policive në qarqe, janë krijuar seksionet për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje. Këto struktura të krijuara prej vitit 2007, kanë për detyrë parandalimin dhe luftën ndaj dhunës në ambientet familjare, dhunën ndaj të miturve, si dhe mbrojtjen e të miturve nga veprimtaria kriminale dhe të fëmijëve të përfshirë në aktivitete kriminale.

101. Njësia për parandalimin e torturës pranë Avokatit të Popullit është krijuar në vitin 2008 dhe ka si qëllim mbrojtjen e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim. Kjo njësi funksionon pranë Avokatit të Popullit dhe ushtron detyrat e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

102. Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, është një strukturë e krijuar në prill të vitit 2011, në vartësi të MPÇSSHB-së, e cila është përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për të drejtat e fëmijës”.

E. Kuadri ligjor që promovon të drejtat e njeriut në nivel kombëtar

103. Masat e marra nga autoritetet dhe agjencitë shtetërore, subjektet juridike dhe OJF-të në promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në nivel kombëtar kryesisht janë të formave: seminare, trajnime, përkthime konventash, publikime, reklama, fushata sensibilizuese etj.

104. Statistika të Departamentit të Administratës Publike pranë Ministrisë së Brendshme deklarojnë se gjatë periudhës së viteve 2003-2010 janë trajnuar, në çështje mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, gjithsej 1105 punonjës të administratës publike. Çështjet e trajtuara në këto trajnime/seminare, kanë pasur kryesisht si temë: i) përkatësinë gjinore; ii) respektimin e të drejtave të minoriteteve; iii) politikat gjinore dhe BE; iv) politikat sociale dhe BE; v) zbatimin e ligjit për të huajt; vi) migracionin dhe direktivat e BE-së; vii) ofrimi i shërbimit të riintegrit për emigrantët; viii) ofrimi i shërbimit për personat me aftësi të kufizuar; ix) e drejta për informim; x) migracionin dhe politikat ndërkombëtare etj.

105. Pjesëmarrësit në këto trajnime janë përfaqësues të institucioneve të administratës publike në nivel qendror dhe atë lokal. Për periudhën 2005-2010, nga trajnimet për të drejtat e njeriut kanë përfituar 1403 punonjës policie. Temat më kryesore të këtyre trajnimeve kanë qenë: i) Mbrojtja e të drejtave të njeriut; ii) Mbrojtja e të drejtave të fëmijës; dhe iii) Dhuna në familje.

106. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me institucione të tjera dhe OJQ të ndryshme kanë iniciuar dhe zhvilluar takime në nivelin teknik, të cilat kanë konkluduar me nënshkrime të marrëveshjeve të bashkëpunimit apo edhe hartimin e planveprimeve me drejtim kryesor mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut në përgjithësi, si dhe grave e fëmijëve në veçanti.



107. Në kuadër të promovimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, struktura të policisë së shtetit në nivel qendror dhe lokal, kanë organizuar në bashkëpunim me median një sërë emisionesh apo kronikash sensibilizuese.

108. Formë tjetër promovimi është edhe trajtimi i dokumenteve bazë të të drejtave të njeriut në kurrikulat shkollore. Në funksion të kësaj strategjie arsimore, Departamenti për Trajnimin Policor në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ka përfshirë në programin shkollor të Shkollës së Policisë dokumente të tilla si: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore; Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike; Konventa Europiane mbi të Drejtat e Njeriut, Konventa për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Çnjerëzore dhe Degraduese etj. Temat e trajtuara në programin arsimor që zhvillon ky departament prekin çështje që lidhen me: zbatimin e ligjit; kodin e sjelljes dhe etikën policore; parimet e policimit në demokraci; respektimin e të drejtave të njeriut; si dhe të personave që u privohet liria gjatë veprimtarisë së Policisë së Shtetit siç janë të shoqëruarit, të arrestuarit dhe të ndaluarit në ambientet e policisë; ndërgjegjësimin mbi diversitetin; trajtimin e mosmarrëveshjeve dhe zgjidhjen e konflikteve; policimin në komunitet dhe parandalimin e krimeve; dhunën në familje etj.

109. Një praktikë mjaft pozitive në kuadër të promovimit të lirive dhe të drejtave të njeriut është ndjekur edhe nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Krahas trajnimeve të udhëhequra nga nëpunës të administratës së saj, një punë e mirë është bërë me hartimin e broshurave (të shoqëruara me parathënie shpjeguese) në gjuhën shqipe të konventave më të rëndësishme ndërkombëtare.

110. Një vend të rëndësishëm në promovimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut zë media e shkruar dhe ajo televizive. Në kronikat sociale, aktualitetit dhe opinioneve ato pasqyrojnë çështje që lidhen ngushtë me këtë temë. Një nga mediat me shtrirje më të gjerë në vend, Radio-Televizioni Publik Shqiptar, i cili ka në varësinë e tij kanalën e radios “Radio Tirana” dhe kanalën televiziv “Televizioni Shqiptar”, në përputhje me ligjin “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë” transmeton gjashtë orë program në ditë, nga e hëna deri të shtunën, në gjuhët: anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, turqisht, greqisht dhe serbisht. Një vend të veçantë në këto emisione zënë rubrikat lidhur me pakicat kombëtare dhe gjuhësore të vendit, duke përcjellë nga afër aktivitetet dhe veprimtaritë mbi historinë, kulturën, folklorin dhe traditat e minoriteteve kombëtare greke, maqedonase, malazeze dhe atyre gjuhësore vllahe dhe rome. Në programet e tij tokësore, RTSH-ja i ka kushtuar një rëndësi të veçantë promovimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri, problematikeve të tyre shoqëruese, duke vënë theksin në kërkimin e rrugëzgjdhjeve për arritjen e standardeve më të larta. Në këtë kuadër, një peshë specifike jo të vogël ka pasur edhe trajtimi i veçorive të komuniteteve të pakicave kombëtare në Shqipëri, problemet e pozicionit të tyre aktual shoqëror, marrëdhëniet e komunikimit me ta, si edhe kërkimit të rrugëve, mundësive dhe alternativave më efektive për integrimin e tyre në shoqëri.

F. Procesi i raportimit në nivel kombëtar

111. Në lidhje me procesin e hartimit të raporteve mbi zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare në kuadër të të drejtave të njeriut, bazuar në procedurat e brendshme ligjore krijohen grupet ndërinstucionale të punës në të cilat marrin pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme shtetërore kompetente.

112. Konkretisht në bazë të urdhrorit të Kryeministrit nr. 201, datë 5.12.2007 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Raporteve Kombëtare në kuadër të Marrëveshjeve Ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë” është ngarkuar Ministria e Punëve të Jashtme me detyrën e hartimit të Raporteve Kombëtare Periodike në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe të pavarura sipas fushës së kompetencës së tyre. Këto raporte kanë si qëllim të pasqyrojnë masat e ndërmarra lidhur me zbatimin në praktikë të instrumenteve ndërkombëtare, situatën aktuale, progresin e arritur, si dhe problemet në fushën e të drejtave të njeriut.

113. Gjithashtu në procesin e hartimit të raporteve konsultohet dhe bashkëpunohet me shoqërinë civile (organizatat jofitimprurëse), aktive në fushën e respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat japin kontributin e tyre në sigurimin e informacionit të nevojshëm, si dhe opinionet e tyre lidhur me draftet e raporteve të përgatitura nga institucionet kompetente. Në fazën përfundimtare draftet e raporteve u

paraqiten ministrive për të marrë opinionet dhe mendimet e tyre përfundimtare, me qëllim vijimin e procedurave të mëtejshme për miratimin e këtyre raporteve me vendim të Këshillit të Ministrave. Sipas nenit 118 të Kushtetutës, aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë. Vendimet e Këshillit të Ministrave janë akte nënligjore në kompetencë të këtij organi dhe nuk kalojnë për miratim në Kuvendin e Shqipërisë. Raportet lidhur me zbatimin e konventave për të drejtat e njeriut publikohen në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme, apo në faqet zyrtare të ministrive sipas fushave që ato mbulojnë.

114. Pas shqyrtimit të raporteve nga mekanizmat e konventave respektive, me qëllim njohjen dhe informimin mbi vëzhgimet përfundimtare, konkluzionet apo rekomandimet e komiteteve të konventave, nga ana e institucioneve kompetente ndërmerren një sërë masash lidhur me publikimin dhe zbatimin e tyre, konkretisht:

- Përktimi në gjuhën shqipe, si dhe publikimi në faqet zyrtare të institucioneve kompetente (MPJ dhe institucione të tjera kompetente).

- Dërgimi i këtyre konkluzioneve dhe rekomandimeve pranë ministrive të linjës, me qëllim njohjen dhe marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e tyre.

- Në kuadrin e njohjes dhe publikimit të rekomandimeve dhe konkluzioneve organizohen edhe një sërë tryezash të rrumbullakëta me qëllim diskutimin dhe bashkëpunimin për marrjen e masave konkrete për zbatimin e tyre.

115. Në kuadrin e përmbushjes së angazhimeve që rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, gjatë periudhës 2002- aktualisht, Republika e Shqipërisë ka paraqitur raportet periodike respektive, si dhe Raportin lidhur me Mekanizmin e Vëzhgimit Periodik Universal (UPR), në vitin 2009.

116. Gjithashtu rekomandimet e komiteteve përkatëse reflektohen dhe përfshihen në përmirësimin e legjislacionit, në marrjen e masave konkrete, si dhe në hartimin e programeve specifike. Ndërkohë Shqipëria paraqet periodikisht raportet përkatëse në kuadrin e konventave të të drejtave të njeriut. Konkretisht lista e raporteve të paraqitura nga vendi ynë jepet në aneksin nr. 4, bashkëlidhur këtij dokumenti.

3. INFORMACION MBI MOSDISKRIMINIMIN DHE BARAZINË, SI EDHE MJETET EFEKTIVE

G. Kuadri ligjor i brendshëm që garanton barazinë dhe mbrojtjen nga diskriminimi

117. Shteti shqiptar me qëllim respektimin dhe mbrojtjen e barabartë të të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe denoncimit të akteve diskriminuese ndaj tyre, e konsideron parimin e mosdiskriminimit si një detyrim që buron nga orientimet kryesore të vendit në respekt dhe mbrojtje të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Këto të drejta garantohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi në përputhje me standardet ndërkombëtare. Si parim bazë të mbrojtjes, respektimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut, Kushtetuta parashikon barazinë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, bindjet politike, fetare apo filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.

118. Shqipëria është angazhuar, për sa i përket përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve, lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, përfshirë edhe mbrojtjen e barabartë përpara ligjit, si dhe parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

119. Në Republikën e Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare gëzon një pozitë të privilegjuar në raport me të drejtën e brendshme. Neni 5 i Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin që shteti shqiptar të zbatojë të drejtën ndërkombëtare. Mbi këtë bazë, konventat ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, të cilat parashikojnë edhe dispozita për garantimin e të drejtave pa asnjë lloj diskriminimi të bazuar në kombësinë, origjinën etnike apo sociale, seksin, racën, ngjyrën, gjuhën, fenë, besimin, opinionin politik apo çdo opinion tjetër, pasurinë, lindjen, paaftësinë, moshën ose çdo gjendje tjetër, në të cilat Republika e Shqipërisë ka aderuar apo i ka ratifikuar, janë bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm. Në këtë kuadër, shteti shqiptar angazhohet për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe



lirive themelore të përcaktuara nga këto akte ndërkombëtare, në fushat ekonomike, sociale, kulturore, politike, ose në çdo fushë tjetër, pa asnjë lloj diskriminimi.

120. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni shqiptar garantojnë barazinë para ligjit, mosdiskriminimin mbi bazën e racës, gjinisë, etnisë dhe gjuhës, si dhe dispozita në ligje të veçanta, të cilat garantojnë lidhur me mosdiskriminimin në fusha të ndryshme. Kushtetuta garanton parimin e përgjithshëm të barazisë të gjithë individëve para ligjit (neni 18, paragrafi 1) dhe ndalon diskriminimin e padrejtë për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindja politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore (neni 18, paragrafi 2). Në paragrafin 3 të nenit 18 parashikohet se “Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”. Ky përcaktim i Kushtetutës krijon mundësinë për zbatimin e diskriminimit pozitiv për marrjen e masave specifike favorizuese, duke u dhënë mundësi të veçanta trajtimi apo përkrahje individëve apo kategorive të caktuara individësh apo grupesh, kur për këtë ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

121. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit, duke garantuar parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të të gjithë shtetasve. Në këtë prizëm, ky kod parashikon një sërë veprash penale që specifikojnë kryerjen e krimeve me natyrë diskriminuese, konkretisht neni 73 “Gjenocidi”; neni 74 “Krime kundër njerëzimit”; neni 253 “Shkelja e barazisë së shtetasve”; neni 265 “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve ndërmjet kombësive, racave dhe feve”; neni 266 “Thirrja për urrejtje nacionale”; në nenet 131, 132 parashikohet si veprë penale shkatërrimi i objekteve të kultit, krijimi i pengesave për organizatat fetare për ushtrimin e lirë të veprimtarisë së tyre. Me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 9686 datë 26.2.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është parashikuar ndër rrethanat rënduese, kryerja e veprës penale e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, fenë, kombësinë, gjuhën, bindjet politike, fetare, ose sociale (neni 6).

122. Me disa shtesa dhe ndryshime që iu bënë “Kodit Penal”, me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008, u parashikuan një sërë veprash penale të reja mbi kryerjen, ndjekjen dhe ndëshkimin e tyre që lidhen me racizmin dhe diskriminimin në sistemet kompjuterike, me qëllim penalizimin e shpërndarjes së materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik dhe fyerjes për motive raciste dhe ksenofobie. Konkretisht, veprat e reja të shtuara në Kodin Penal janë: neni 74/a “Shpërndarja kompjuterike e materialeve pro gjenocidit ose krimeve kundër njerëzimit”; neni 84/a “Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik”; neni 119/a parashikon si veprë penale shpërndarjen e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik, ndërsa neni 119/b përcakton fyerjen e qëllimshme publike me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik, që i bëhet një personi, për shkak të përkatësisë etnike, kombësisë, racës apo fesë.

123. Kodi i Procedurës Penale miratuar me ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, me ndryshimet përkatëse, në nenin 1 përcakton se legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë dhe të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale, të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë në forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës dhe ligjeve të vendit.

124. Kodi Civil miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, me ndryshimet përkatëse, përcakton se çdo person fizik gëzon zotësi të plotë dhe të barabartë për të pasur të drejta dhe detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj.

125. Kodi i Procedurës Civile miratuar me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, me ndryshimet përkatëse, ka si parim themelor caktimin e rregullave të detyrueshme, të njëjta e të barabarta, për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta.

126. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, me ndryshimet përkatëse sanksionon mbrojtje nga aktet diskriminuese ndaj të gjithë shtetasve në fushën e punës dhe sigurimeve shoqërore. Lidhur me marrëdhëniet në fushën e punës, si në atë publike, ashtu edhe atë private, ndalohet çdo lloj diskriminimi në punësim apo në jetën profesionale (neni 9 i Kodit të Punës). Ndërsa legjislacioni për sigurimet shoqërore, sikurse janë sigurimet shëndetësore apo sigurimet

për të gjitha llojet e pensioneve (invaliditetit apo pleqërisë), ofron të drejta të barabarta për të gjithë individët, pavarësisht nga kombësia apo raca. Diskriminimi mund të sjellë si pasojë sanksione me shuma deri në 50-fishin e pagës minimale mujore (neni 202 i Kodit të Punës). Ky Kod pasqyron dispozitat e Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), nr. 111.

127. Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, në nenin 11, paragrafi 1 përcakton ndër të tjera se “në marrëdhëniet me personat privatë, administrata publike udhëhiqet nga parimi i barazisë edhe në kuptimin që askush nuk duhet të privilegjohej apo diskriminohet”.

128. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë (neni 3) sanksionon që: “Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod”.

129. Kodi i Familjes, në lidhje me përkufizimin e martesës, deklaron barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve si një parim bazë të rëndësishëm të jetës. Ky Kod trajton hollësisht mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe në të përfshihen parimet e përgjithshme të konventave, akteve dhe instrumenteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa asnjë diskriminim dhe veçanërisht dispozita të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

130. Ligji nr. 9669, datë, 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, ka si qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore, si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë dhunës ndaj grave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Ligji nr. 10 329, datë 30.9.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006”, ka si qëllim kryesor zgjidhjen e disa problematikave që kanë dalë gjatë zbatimit në praktikë të tij, si dhe ngritja e mbështetja e strukturave të posaçme përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje. Miratimi i ligjit të ndryshuar i hap rrugën ngritjes së strehëzës së parë kombëtare për viktimat e dhunës në familje, krijimit të sistemit të referimit në nivel vendor dhe ofrimit të ndihmës ligjore falas për viktimat e dhunës në familje.

131. Legjislacioni në fushën e arsimit: Kuadri ligjor në fushën e arsimit mbron dhe promovon të drejtat e njeriut dhe parandalon të gjitha format e diskriminimit të individëve. Neni 3 i ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin e arsimit parauniversitar” (i ndryshuar me ligjin nr. 8387, datë 30.7.1998), garanton ndër të tjera të drejta të barabarta për të gjithë shtetasit për t’u arsimuar në të gjitha nivelet e arsimit që përcaktohen nga ky ligj.

132. Ligji nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional” (ndryshuar në vitin 2011) garanton të drejtën e parashikuar në Kushtetutë për arsimin dhe formimin profesional gjatë gjithë jetës, si dhe mundësinë për të fituar njohuri profesionale të nevojshme për tregun e punës, duke krijuar shanse të barabarta për të gjithë.

133. Ligji nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar) ka si mision ofrimin e mundësive për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë të gjithë jetës, pa asnjë lloj diskriminimi.

134. Legjislacioni në fushën e shëndetësisë mbështetet shprehimisht edhe në parimin e mosdiskriminimit, duke garantuar mbrojtjen e shëndetit për të gjithë individët pa asnjë dallim. Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, i vitit 2002 parashikon ndër të tjera se mjeku duhet të ofrojë ndihmë mjekësore të njëjtë për të gjithë pa asnjë dallim, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e çdo individi.

135. Ligji nr. 9952, datë 14.7.2008 “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it”, parashikon rregullat për parandalimin dhe kontrollin në marrjen e masave për HIV/AIDS-in, kujdesin, trajtimin dhe mbështetjen për personat që jetojnë me HIV/AIDS, pa asnjë lloj diskriminimi. Ky ligj e konsideron si akt të ndaluar stigmatizimin dhe diskriminimin e një personi që jeton me HIV/AIDS.



136. Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, (i ndryshuar) thekson se skema e funksionimit të ndihmës ekonomike dhe ofrimit të shërbimeve shoqërore mbështetet në parimin e mosdiskriminimit.

137. Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i plotësuar me ligjin nr. 8600, datë 10.4.2000, ndryshuar me ligjin nr. 9398, datë 12.5.2005, në nenin 2 të tij, përcakton se Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve, të cilat mund të cenohen nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Avokati i Popullit i udhëhequr nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë ushtron veprimtarinë në mbrojtje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, të parashikuara në dispozitat kushtetuese dhe ligjet.

138. Në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007, (i ndryshuar), “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i cili ka për qëllim mbrojtjen e fëmijës nëpërmjet vendosjes në një familje të përhershme duke marrë masa që kjo mbrojtje të bëhet në interesin më të lartë të fëmijës, ndër të tjera në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 33 të tij parashikon se agjencitë ndërmjetëuese në fushën e birësimit duhet të mos paragjykojnë dhe të mos diskriminojnë aplikantët birësues, pavarësisht nga raca, origjina apo bindjet e tyre fetare.

139. Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” përcakton rregullat për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, parashikon rregulla të veçanta për të dhënat personale të personit fizik (ose si quhen ndryshe në këtë ligj “të dhëna sensitive”) që kanë të bëjë me origjinën e tij racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal, si edhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

140. Gjithashtu, mbrojtje të barabartë dhe pa diskriminim përpara ligjit gëzojnë edhe të huajt në Republikën e Shqipërisë. Ligji nr. 9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt” mbështetet në parimin e reciprocitetit, mosdiskriminimit dhe të trajtimit jo më pak të favorshëm se shtetasit shqiptarë (neni 2).

141. Ligji nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”¹⁹, (i ndryshuar) i cili përcakton kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, rregullon në mënyrë më të plotë dhe të detajuar gjendjen civile, si dhe përcakton përbërësit dhe veçoritë e gjendjes civile.

142. Ligji nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, synon rregullimin ligjor të dhënies së ndihmës juridike që shteti u ofron personave me mundësi të pamjaftueshme ekonomike, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore dhe interesave të tyre të ligjshme në gjykata apo organe të tjera shtetërore. Dhënia e ndihmës juridike nga shteti për individët mbështetet në parimin e barazisë së të drejtave për të gjithë individët, që përfitojnë nga ndihma juridike.

143. Mbrojtje nga aktet e diskriminimit parashikojnë gjithashtu, Kodi i Etikës së Policisë (miratuar me ligjin nr. 8291, datë 25.2.1998), si dhe ligji nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Këto akte parashikojnë përgjegjësinë e forcave të policisë për veprime të kundërligjshme, si dhe procedurat e ankimit për raste të diskriminimit në polici. Ligji “Për Policinë e Shtetit” përcakton se punonjësi i policisë duhet t’i trajtojë personat në mënyrë të barabartë dhe duhet t’i kryejë detyrat pa diskriminim në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit, etnisë, bindjeve politike, fetare ose filozofike, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore, në përputhje me nenin 18 të Kushtetutës (neni 61).

144. Ligji nr. 10 002, datë 6.10.2008 “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Brendshme” parashikon shprehimisht se “Punonjësi i Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm ka për detyrë t’i trajtojë personat në mënyrë të barabartë dhe t’i kryejë detyrat pa diskriminim, në përputhje me ligjin dhe standardet e kërkuara, si dhe të respektojë dinjitetin dhe integritetin fizik të çdo punonjësi tjetër të shërbimit”.

¹⁹ Ligji nr. 10 129, datë 11.5.2009 është ndryshuar, pasi Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 52, datë 1.12.2011, e ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën termin “kombësi” në nenet 6/1, 8, 42/2 germa “e” dhe të nenit 58 të tij, dispozitë në të cilën rregullohej çështja e kombësisë së shtetasve.

145. Për sa i përket fushës së medias, ligji nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radio televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 39 parashikon se ndalohej “transmetimi i programeve që nxisin dhunën, luftën agresive, urrejtjen kombëtare dhe raciale”. Po ashtu, ligji “Për shtypin”, nr. 7756, datë 11.10.1993, i ndryshuar me ligjin nr. 8239, datë 3.9.1997, aktualisht ka vetëm një nen në të cilin përcaktohet: “..shtypi është i lirë. Liria e shtypit mbrohet me ligj”. Mbi bazën e këtij ligji të gjithë shtetasit shqiptarë, përfshirë edhe personat që u përkasin minoriteteve kanë të drejtë, pa asnjë pengesë të krijojnë, median e tyre të shkruar, e cila nuk i nënshtrohet censurës paraprake.

146. Ligji nr. 9668, datë 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, ndryshuar me ligjin nr. 10 389, datë 3.3.2011, përcakton se “e drejta për të emigruar parashikon barazinë e të gjithë shtetasve dhe mosdiskriminimin e tyre”. Në këtë ligj jepen garancitë për mosdiskriminimin e personave për çdo shkak në lidhje me përfitimet e vendosura nga ky ligj, si dhe sanksionohet parimi i rëndësishëm i kufizimit të kësaj të drejte vetëm me vendim gjykate²⁰.

147. Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, bazohet në parimin e barazisë e të mosdiskriminimit dhe në parimet e tjera, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga Konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, si dhe nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Miratimi i këtij ligji shfuqizoi ligjin nr. 9198, datë 1.7.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri” dhe ndryshimet e tjera që i ishin bërë atij me ligjin nr. 9534, të vitit 2006. Për hartimin e këtij ligji është marrë në konsideratë përputhja e tij me direktivat e BE-së. Ligji ka dhënë përkufizimin për diskriminimin gjinor, përkufizim i cili është në përputhje me përkufizimin e dhënë në nenin 1 të Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”.

148. Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, besimet politike, fetare ose filozofike, statusin ekonomik, arsimor ose shoqëror, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, statusin shëndetësor, predispozicione gjenetike, paftësinë, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

H. Aktet nënligjore dhe masat konkrete që garantojnë mbrojtjen nga diskriminimi

149. Në fushën e arsimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës janë nxjerrë një sërë aktesh nënligjore, të cilat garantojnë mbrojtjen nga çdo lloj diskriminimi, konkretisht:

- Udhëzimi nr. 34, datë 8.12.2004 “Për zbatimin e projektit “Shansi i dytë për arsimimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën dhe atyre të ngjuar për shkak të gjakmarrjes”. Ky projekt i adresohet kryesisht fëmijëve romë dhe atyre nga familjet në nevojë.

- Udhëzimi nr. 6, datë 29.3.2006 “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve romë që nuk janë të pajisur me certifikatë lindjeje”.

- Udhëzimi nr. 9, datë 11.4.2007 “Për arsimimin e nxënësve të ngjuar për shkak të gjakmarrjes”.

- Udhëzimi nr. 18, datë 21.4.2008 “Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar”.

- Qarkore, datë 26.11.2006 “Për marrjen e masave për përmirësimin e punës edukative në shkollë dhe parandalimin e dhunës”.

- Udhëzimi nr. 38, datë 9.10.2007 “Për zhvillimin e orëve të lira” në nivelet parauniversitare, me dëshirën e vetë fëmijëve romë janë krijuar të gjitha mundësitë për të zhvilluar orë plotësuese me nxënësit që kanë mangësi në gjuhën shqipe apo vështirësi për të nxënë.

- Udhëzimi nr. 102, datë 10.2.2010 paketa informuese “Alertekst 2011” parashikon kriter për

²⁰ Ligji nr. 9668, datë 18.12.2006 ka shfuqizuar ligjin nr. 9034, datë 20.3.2003 “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”.



vlerësimin e teksteve shkollore, sidomos në respektimin në këto tekste të barazisë gjinore, racën, kombësinë, fenë dhe parimet demokratike.

- Udhëzim i Përbashkët i Ministrisë së Financave dhe MASH, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010, të ndryshuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 212, datë 16.3.2011 pika 6.1, ku fëmijët romë në arsimin parauniversitar përfitojnë 100% mbështetje buxhetore për tekstet shkollore dhe tërheqjen e tyre pranë shkollave.

- Udhëzim nr. 35, datë 31.8.2011, krijon kushtet dhe mundësitë për të gjithë romët, për të ndjekur arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atë profesional me kohë të pjesshme dhe të shkurtuar.

150. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 759, datë 15.9.2010, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbështetur në kërkesat e DAR/ZA-ve, ka hartuar planin e shpërndarjes së bursave dhe brenda kuotave të miratuara, ka rekomanduar bashkitë dhe komunat për t'u dhënë prioritet nxënësve dhe studentëve që i përkasin komunitetit rom.

151. - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 14.9.2011 "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i dytë i studimeve "Master profesional" për vitin akademik 2011-2012", u planifikuan 20 kuota të lira për romët.

152. - Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 423, datë 8.6.2011 "Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, si dhe edukimit në distancë në vitin akademik 2011-2012", për romët dhe ballkano-egjiptianët u planifikuan 20 kuota të lira për secilën formë studimi dhe aplikantët janë përjashtuar nga tarifat e shkollimit.

153. Gjithashtu, Ministria e Arsimit dhe Shkencës që prej vitit 2009 po zbaton Planin Kombëtar për Braktisjen Zero 2009-2013 në arsimin bazë dhe në gjimnaz, në bashkëpunim me orgnazata joqeveritare dhe jofitimprurëse të interesuara në këtë fushë. Në një pjesë të konsiderueshme të tij, ky plan prek drejtpërsëdrejti minoritetin rom, si dhe shtresat në nevojë dhe me probleme sociale.

154. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2004-2015 (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 12.8.2004 dhe Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë (2008-2013), kanë si objektiv garantimin e aksesit në të gjitha nivelet e arsimit pa asnjë lloj diskriminimi dhe përmirësimin cilësor të arsimit.

155. Strategjia Kombëtare për Fëmijët (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 368, datë 31.5.2005, përcakton objektivat strategjike në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve ndaj çdo lloj forme të dhunës, abuzimit dhe diskriminimit. Një ndër objektivat e Strategjisë është siguri i mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët, pavarësisht gjinisë, racës, etnisë, moshës, gjendjes shëndetësore, statusit të lindjes, aftësisë së kufizuar fizike e mendore, me qëllim realizimin e të drejtës për mbrojtje shoqërore.

156. Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, si dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Viktima të Trafikimit 2011-2013 (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 23.2.2011), ka si qëllim marrjen e masave konkrete për hetimin, parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, përfshirë edhe fëmijët pa asnjë lloj diskriminimi.

157. Procedurat standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave të mundshme të trafikimit (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 582, datë 27.7.2011) bëhet me qëllimin kryesor identifikimin, mbrojtjen dhe dhënien e ndihmës ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

158. Strategjia ndërsektoriale e përfshirjes sociale (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 218, datë 3.2.2008) është një pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Objektivat e kësaj strategjie synojnë përfshirjen e grupeve dhe individëve, si dhe mbulimin e nevojave të tyre nëpërmjet programeve që synojnë rritjen e të ardhurave apo atë të shërbimeve alternative.

159. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 20.7.2011) dhe plani i veprimit që e shoqëron, parashikon objektiva dhe masa konkrete për institucionet dhe hallkat e sistemit të drejtësisë për periudhën 2011-2013 me qëllim përsosjen më tej të këtij sistemi, rritjen e aksesit dhe rritjen e besimit të publikut në drejtësinë shqiptare.

160. Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 7.1.2005) dhe plani i saj i veprimit ka si objektiv vendosjen e bazave për përmirësimin e jetës së personave me aftësi të kufizuara në fushën e kujdesit social, mjekësor, arsimit, kulturës, sportit, punësimit, informimit, transportit, si dhe përfaqësimit dhe pjesëmarrjes në jetën publike. Një ndër parimet bazë të strategjisë është parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, që garanton ndër të tjera, mosdiskriminimin në asnjë fushë të jetës.

161. Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 80, datë 28.1.2008), mbështetet në parimin e mosdiskriminimit dhe ka si objektiv mbrojtjen e të drejtave, barazisë, parandalimin dhe mosdiskriminimin në përfitimin e shërbimeve. Në këtë strategji parashikohet se mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, origjina, feja, mosha, aftësitë e kufizuara, ose shkaqe të tjera. Ndërsa vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1104, datë 30.7.2008 “Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 80 datë 28.1.2008 “Për miratimin e strategjisë sektoriale të mbrojtjes sociale dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj””, parashikon shmangien e diskriminimit, nëpërmjet përcaktimit të kriterëve të familjes kujdestare.

162. Strategjia Kombëtare “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom” (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 633, datë 18.9.2003, përcakton si objektiv kryesor eliminimin e çdo lloji forme diskriminimi ndaj këtij minoriteti, duke synuar përmirësimin e kushteve të jetesës së këtij minoriteti.

163. Në vitin 2008 Qeveria Shqiptare është anëtarësuar në iniciativën “Dekada e Përfshirjes së Romëve” duke u angazhuar për realizimin e objektivave në fushat e punësimit, arsimimit, strehimit dhe shëndetit, si dhe për të nxitur dhe mbështetur pjesëmarrjen dhe përfshirjen e minoritetit rom në këtë proces. Në vitin 2009 është hartuar Plani Kombëtar i Veprimit për zbatimin e kësaj iniciative, në bashkëpunim me institucionet qendrore, pushtetin vendor, organizatat rome, shoqërinë civile dhe asistencën e UNDP-së. Vlen të theksohet kontributi i organizatave rome në mbledhjen e të dhënave, identifikimin e nevojave, propozimet konkrete.

164. Sekretariati teknik për romët zhvillon takime periodike për shkëmbim informacioni, si dhe konsultime me përfaqësues të shoqatave Rome dhe merr masa për vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet përfaqësuesve rom dhe strukturave të Pushtetit Vendor. Si rezultat janë ngritur në nivel qarku grupet teknike për çështjet rome, të cilat janë mekanizma që do të mbështesin këtë komunitet të ketë akses të gjerë në shërbimet publike të ofruara në nivel lokal.

165. Dokumenti ndërsektorial zhvillues të moshimit (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 763 datë 11.6.2009), përbën një dokument specifik që adreson masa konkrete specifike për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të të moshuarve.

166. Rregullorja e paraburgimit (miratuar me urdhrin nr. 3705/1, datë 11.5.2006, të Ministrit të Drejtësisë) ka si objekt trajtimin njerëzor pa asnjë lloj diskriminimi, bazuar në standardet ndërkombëtare duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e njeriut, gjatë procesit të mbajtjes në institucionet e paraburgimit.

167. Për trajtimin e personave të arrestuar dhe të ndaluar në ambjentet e Policisë së Shtetit janë shfuqizuar të gjitha aktet e mëparshme nënligjore që përcaktonin rregullat për sigurimin e trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar duke hartuar e miratuar akte të reja në zbatim të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”. Fillimisht me urdhrin nr. 64, datë 25.1.2010, të Drejtorit Përgjithshëm të Policisë u miratua manuali për rregullat e trajtimit dhe sigurimit të ndaluarve dhe arrestuarve në njësitë policore. Më pas ky manual u rishikua e përmirësua dhe me urdhrin nr. 763, datë 27.9.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit u miratua “Manuali i Rregullave dhe Procedurave Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe të Ndaluar në Njësitë Policore”. Ky manual ofron garanci dhe mundësi të plota për respektimin dhe garantimin e të drejtave të personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, mbrojtjen nga diskriminimi etj.

168. Me qëllim unifikimin dhe standardizimin e njëjtë të punës dhe veprimtarisë së personelit policor janë miratuar procedurat standarde të punës së shërbimeve të Policisë së Shtetit. Pjesë përbërëse e këtyre procedurave janë dhe ato që kanë të bëjnë me respektimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut dhe në veçanti të personave që u është privuar liria (të shoqëruar, arrestuar dhe të ndaluar).



169. Me qëllim komunikimin dhe njohjen e personave të arrestuar/ndaluar me të gjitha të drejtat që iu njeh ligji është miratuar formati i “Deklaratës për informimin dhe njohjen me të drejtat ligjore, për personat e arrestuar/ndaluar në Policinë e Shtetit”, në të cilën janë pasqyruar të gjitha të drejtat e personave të arrestuar/ndaluar të cilat pasi iu bëhen të njohura nga personeli policor nënshkruhen nga personi i arrestuar/ndaluar.

170. Rregullorja e Disiplinës së Policisë së Shtetit (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 4.6.2008), parashikon se punonjësi i policisë duhet të zbatojë detyrimet e normat e sjelljes, si dhe “të trajtojë në mënyrë të barabartë personat dhe të kryejë detyrat pa diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, besimit, etnisë, bindjeve politike, fetare ose filozofike, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësisë prindërore”.

171. Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 303, datë 25.3.2009), parashikon detyrimin e administratës së burgjeve për realizimin e trajtimit njerëzor dhe edukues të të dënuarve nëpërmjet mënyrave efektive moderne të administrimit, pa diskriminim për arsye race, ngjyre, seksi, gjuhe, feje, mendimi politik, origjinës kombëtare, ose shoqërore, gjendjes ekonomike etj.

172. Rregullorja “Për organizimin e funksionimin e shërbimit të provës dhe për përcaktimin e standardeve të procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative” (miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 25.3.2009), parashikon se shërbimi i provës siguron që në veprimtarinë e tij të mos ketë diskriminim mbi bazën e racës, ngjyrës, gjinisë, lindjes, gjuhës, kombësisë, etnisë apo origjinës sociale, mendimeve politike apo të tjera, fesë, kushteve fizike apo mendore, statusit ekonomik apo çdo statusi tjetër.

173. Në rregulloren “Për bashkëpunimin e shërbimit të provës me organizatat jofitimprurëse dhe shërbimin e ndërmjetësimit” (miratuar me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 6325, datë 31.7.2009), përcaktohet shprehimisht se shërbimi i provës dhe OJF-të apo shërbimi i ndërmjetësimit, sigurojnë që në veprimtarinë e tyre të mos ketë diskriminim mbi bazën e racës, ngjyrës, gjinisë, lindjes, gjuhës, kombësisë, etnisë apo origjinës sociale, mendimeve politike apo të tjera.

174. Rregullorja “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për marrëdhënien e punës, trajnimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve” (miratuar me urdhrin nr. 3125/1, datë 4.9.2009 e Ministrit të Drejtësisë) përcakton shprehimisht se gjatë veprimtarisë së tyre, punonjësit e Policisë së Burgjeve udhëhiqen nga parimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, parimi i mosdiskriminimit dhe parimi i ligshmërisë.

175. Rregullorja e Shërbimeve të Shëndetit Mendor, (miratuar me urdher të Ministrit të Shëndetësisë nr. 118, datë 15.5.2007) përcakton se shërbimet e shëndetit mendor duhet t’u ofrohen të gjithë personave të sëmurë mendorë pa asnjë dallim gjinor, racor, fetar, etnie, moshe, gjuhe dhe duhet të garantohet në çdo rrethanë dhe çdo moment të ushtrimit dhe respektimit të të drejtave të tyre.

176. Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Komisionit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe Kryetares së Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike, nënshkruar në datën 1.4.2011, i cili parashikon format e bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve me qëllim realizimin e mbrojtjes efektive nga diskriminimi apo çdo formë tjetër sjelljeje që nxit diskriminimin përmes dhënies me përparësi të ndihmës juridike në çështjet që lidhen me shkeljen e të drejtës për barazi përpara ligjit.

I. Mjetet juridike efektive që garantojnë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kundër diskriminimit

177. Në varësi të shkeljes së të drejtave dhe lirive, rrugët për mbrojtjen e të drejtës përfshijnë ankimin administrativ dhe/ose ankimimin gjyqësor. Në rastet e ankimit administrativ kompetente për zgjidhjen janë të gjitha organet administrative, të cilat veprojnë në bazë të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjisllacionit përkatës në fuqi. Specifikisht për rastet e diskriminimit gjinor, ligji nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, neni 30 përcakton se çdo ankesë për shkeljen e barazisë gjinore, sipas këtij ligji, shqyrtohet ose gjykohet nga organet administrative, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, palët, në mënyrë të lirë mund të ndjekin procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me pajtim ose ndërmjetësim. Gjithashtu, ligji u njeh të drejtën e ndjekjes së çështjeve pranë organeve administrative dhe gjykatës kompetente.

178. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, apo dhe në rastin e akuzave të ngritura kundër tij ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm dhe nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në nenin 135 të Kushtetutës parashikohet se pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga gjykatat e apelit, si dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Neni 145 përcakton se gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 24.4.2012
Doli nga shtypi më 25.4.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 30 lekë